



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/22 Nr. i faq/Br.str./No.pg 393

Data/Datum/Date 25/11/2022

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), në mbështetje të nenit 8 dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008”), Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2016”), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 65 paragrafi 1 pika 1.13 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec, në mbledhjen e mbajtur me dt. 25.11.2022 miraton këtë:

VENDIM

Miratohet propozimi Kryetarit të Komunës Nr. 02/2926/22 i datës 04.11.2022 dhe merret vendimi për lirim nga pagesa në shërbimin mjekësor “Mamografia” për të gjitha gratë e Komunës së Rahovecit, që ofrohet nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

1. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.393/22
Me datë:25.11.2022

